



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.377/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.06.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Curri” sh.p.k nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-12537-03-06-2019, me objekt: “*Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha*”, me fond limit 208,243,180.9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Ankimues: “Curri” shpk
Rruga “Kajo Karafili”, nd.2, H.4, Ap.3, Njësia Bashkiake nr.10-Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia e Tiranës
Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe*

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 06.03.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-12537-03-06-2019, me objekt: “*Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha*”, me fond limit 208,243,180.9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 08.04.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

CURRI	140,380,077	I skualifikuar
4 A-M	143,549,535	I skualifikuar
EURONDERTIMI 2000	143,934,777.63	I skualifikuar
AGI KONS&BE IS	158,152,462	I skualifikuar
V.A.S. Konstruksion&Sterkaj	158,033,075.03	I kualifikuar
ARIFAJ	162,146,112.70	I skualifikuar
S p e k t r i&Ed Konstruksion&Alba Konstruksion	162,248,654.2	I kualifikuar
Ante-Group	165,705,424.5	I kualifikuar
GJIKURIA	170,749,261	I kualifikuar
SALILLARI	170,748,143	I kualifikuar
S I R E T A 2F	174,444,444	I kualifikuar
2 T	176,244,804.75	I skualifikuar

II.4. Në datën 19.04.2019 operatori ekonomik “Curri” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 4 të Kapaciteti Teknik Dokumentave Standarte të Tenderit: “List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shkurt 2018 - Shkurt 2019, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore, pasi nuk ka paraqitur urdhër pagesat për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhen Shkurt 2018 - Shkurt 2019.*
- *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.*
- *Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi. Gjate verifikimit te dokumentacionit u konstatua se per dy nga punonjësit e deklaruar, Dëshmia e Kualifikimit te sigurimit teknik nuk është e kategorisë IV. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi të vertetuar me kontrata e pune te vlefshme; diplomë përkatëse, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. •*

- *Operatori ekonomik ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) “punonjës Hekurthyes”, nga 4 (katër) të kërkuar, cka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9.*
- *Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi sigurimit teknik, (të vlefshme)..../ 4 (katër) punonjës karpentier “ pasi nga 5 (pesë) punonjës karpentier të deklaruar, për dy prej tyre dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, rezultojnë të pavlefshme, konkretisht data e përfundimit të vlefshmërisë 26.3.2019 dhe 27.3.2019.*
- *Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....” pasi për dy autopompat e deklaruar në dokumentacionin e paraqitur mungon Akti i Pronësisë.*
- *Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....” pasi është paraqitur dokumentacion për 4 (katër) autobetoniere, ku për 3 (tre) prej tyre nuk janë paraqitur Aktet e Pronësisë. • Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.*

II.5. Në datën 24.04.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Në lidhje me pretendimin për mosdorëzim të listpagesave sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi , në përputhje me kërkesat për të vërtetuar kapacitetin teknik 2.3 pika 4 për të dëshmuar punësimin e 90 punonjësve për periudhën Shkurt 2018-Shkurt 2019 kemi dorëzuar: Vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore për numrin e punonjësve , Listpagesat për vitin 2018 dhe vitin 2019, Vërtteimin për pagimin e detyrimeve. Me këto dokumenta kemi vërtetuar që plotësojmë këtë kriter të vendosur nga AK , pra kemi të punësuar më shumë se 90 punonjës për periudhën Shkurt 201-Shkurt 2019 dhe nuk kemi detyrime të papaguara, të cilat në rast se do të kishim do të rezultojnë me gjoba dhe kamatvonesa në sistemin informatik tatimor.*
- *Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit,*

Kapaciteti Teknik, pika 5. Nuk kuptojmë se si ka arritur në këtë konkluzion KVO. Në përputhje me këtë kërkesë ne kemi paraqitur kontratën me inxhinierin Kol Dedaj me nr.607 rep Nr.107 Kol datë 10.11.2018 lidhur para noterit Ndoc G Topalli.

- Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi. Gjate verifikimit te dokumentacionit u konstatua se per dy nga punonjësit e deklaruar, Dëshmia e Kualifikimit te sigurimit teknik nuk është e kategorisë IV. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi të vertetuar me kontrata e pune te vlefshme; diplomë përkatëse, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Sqarojmë se Për të disatën herë kemi ndeshur këtë absurditet në këto kërkesa që në vetvete janë absurde. Ju lutem na sqaroni cila është baza ligjore ku jeni mbështetur për të kërkuar dhe vendosur këtë lloj kategorizimi që teknikët e ndërtimit duhet të kenë dëshmi të sigurimit teknik të kategorisë IV. Ne presim të na sqaroni se cila është baza ligjore ku jeni mbështetur për këtë kërkesë. Mbështetur në rregulloren e miratuar që në njohim kategorinë IV e marrin vetëm: Personeli elektronik mjeshtra elektromontjer, personeli i ndërresës në centrale, nënstacione dhe i rrjetit elektrik. Teknikë dhe inxhinierë të rinj.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit Operatori ekonomik ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) “punonjës Hekurthyes”, nga 4 (katër) të kërkuar, cka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9., sqarojmë se konstatimi juaj është minimalisht i gabuar për të mos thënë i qëllimshëm. Ne kemi në stafin tonë të punësuar aktualisht si hekurthyes 4 punonjës. Sabah Fangaj, Bajram Lugaj, Muharem Shabaj, Ertan Curri. Për këta katër punonjës kemi ngarkuar në sistem kontratën e punës shoqëruar me dëshminë e sigurimit teknik në punë.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi sigurimit teknik, (të vlefshme)..../ 4 (katër) punonjës karpentier “ pasi nga 5 (pesë) punonjës karpentier të deklaruar, për dy prej tyre dëshmitë e kualifikimit të sigiurimit teknik, rezultojnë të pavlefshme, konkretisht data e përfundimit të vlefshmërisë 26.3.2019 dhe 27.3.2019. sqarojmë se në përmbushje të kësaj kërkesë ne kemi deklaruar në këtë procedurë prokurimi 5 karpentierë: Gëzim Ademi, Kleant Kola, Isuf Buhaj, Albert Bushishta, Islam Kandri.

Të gjithë këta punonjës janë në listpagesën e deklaruara të shoqërisë dhe kanë dëshmi të vlefshme të sigurimit teknik. Ju keni konstatuar që dy prej ketyre punonjësve kanë dëshmi të sigurimit teknik të pavlefshme. Kjo nuk është e vërtetë. Dëshmitë e tyre të sigurimit teknik janë të vlefshme, por në dokumentin e kontratës bashkëlidhur ka qenë

dëshmia e vjetër dhe jo dëshmia e re e sigurimit teknik. Në fakt është e njëjta dëshmi por vetëm se për cdo vit që bëhet testimi i punonjësve për rregullat e sigurimit teknik në punë bëhet validimi. Bashkëlidhur gjeni dëshminë e sigurimit teknik. Nëse në parimin e AK nuk do të prevalonte qëllimi për të kapur një lapsus por dëshira për të vlerësuar kapacitetet teknike, së pari autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga ofertuesi gjë që ligji i prokurimit publik e kërkon, pasi ky nuk është një dokument që mund të ndryshohet dhe prodhohet nga ne. Ky është një dokument që lëshohet nga një institucion subjekt tjetër i licensuar. Së dyti në mënyrë të pavarur AK mund të bënte verifikime tek sistitucioni subjekti i licensuar që ka lëshuar këtë dokument për vlefshëmrinë e këtij dokumenti.

- Lidhur me arsyet e skualifikimit Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson germën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....” pasi për dy autopompat e deklaruar në dokumentacionin e paraqitur mungon Akti i Pronësisë. Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson germën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....” pasi është paraqitur dokumentacion për 4 (katër) autobetoniere, ku për 3 (tre) prej tyre nuk janë paraqitur Aktet e Pronësisë., sqarojmë se për të vërtetuar kapacitetin teknik të kërkuar në pikën 18 të DST kemi paraqitur një Kontratë Qeraje me nr.603 Rep Nr. 103 Kol datë 10.11.2018 lidhur me shoqërinë Alba-Beton shpk e cila ka bashkëlidhur dokumenetacionin me anë të të cilit noteri është bazuar dhe ka hartuar kontratën e qerasë. Në 20 vite aktivitet që ne kemi noterët kanë hartuar kontrata qeraje mbështetur në lejen e qarkullimit të automjetit i cili është një dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit në pronësi të subjektit me emër ose individit. Akti i pronësisë është dokument që shërben për transaksionet e shitjes dhe të blerjes së automjetit. Në kriterin e vendosur në DST del qartë që ju kërkon një dokument që tregon rregjistrimin e mjetit dhe ky dokument është Leja e Qarkullimit me të gjithë elementët që ajo ka. Arsyeja që keni gjetur për këtë skualifikimi është absurde. Të skualifikosh një ofertë pse nuk ka paraqitur aktin e pronësisë kur rregjistrimin dhe pronësinë e mjetit e tregon leja e qarkullimit, është e qartë se kjo bëhet vetëm që ju të arrini qëllimin tuaj për të favorizuar kompaninë e përzgjedhur nga ju.
- Kompania e përzgjedhur për tu favorizuar: Referuar ekstraktit historik të kësaj kompanie që ju keni përzgjedhur për të shpallur fituese kjo kompani është krijuar në datën 22.01.2016 me emrin Igor Elektrik shpk. Në datën 07.01.2019 kompania ka ndërruar emrin nga Igor Elektrik shpk në VAS Konstruktion shpk kuptohet kjo për ti paraprirë punës për të marrë këtë tender. Në dtaën 07 mars 2019 është bërë dhe hapja e kësaj procedure prokurimi që ka pretenduar të marrë kjo kompani. Pra referuar Bilancit Financiar të dy viteve të kësaj kompanie të publikuar në QKB në asnjë ditë të saj kjo kompani nuk është marrë me aktivitet ndërtimi por vtëm me trgëtim dhe instalime të materialeve elektrike. Këtë kompani ju dhe KVO ka zgjedhur të shpallë fite se pa pasur asnjë eksperiencë të vetme në fushën e ndërtimit. Këtë përzgjedhje e

keni bërë duke shkaktuar një dëm financiar të paktën 18 mil lekë të reja buxhetit të shtetit. Ky është një investigim i shpejtë mbi kompaninë e përzgjedhur nga ana juaj për ta bërë fituese të një pune që kurrë se ka bërë në tre vite aktivitet që ka.

II.6. Me shkresën nr. 17379/2 prot datë 03.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 07.05.2019 operatorit ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.20228/1 prot datë 17.05.2019 protokolluar me tonën me nr.818/2 prot datë 21.05.2019 me objekt *“Dërgohet informacioni”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Curri”* shpk mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi sigurimit teknik, (të vlefshme)..../ 4 (katër) punonjës karpentier “ pasi nga 5 (pesë) punonjës karpentier të deklaruar, për dy prej tyre dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik, rezultojnë të pavlefshme, konkretisht data e përfundimit të vlefshmërisë 26.3.2019 dhe 27.3.2019”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 12 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”*, pika 2.3/9 *”Për kapacitetin teknik”*, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

- *Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:*

- *4 (katër) punonjës murator*
- *4 (katër) punonjës hekurkthyes*

- 4 (katër) punonjës karpentier
- 2 (dy) punonjës saldator

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "Curri" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune datë 01.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe A.B në cilësinë e punëmarrësit . Dëshmi kualifikimi dt leshimit 04.09.2017 dt skadence 03.09.2018 dhe dt leshimit 27.03.2018 dt skadence 26.03.2019
- Kontratë Pune datë 01.01.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe I.B në cilësinë e punëmarrësit. Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik dt leshimit 04.09.2017 dt skadence 03.09.2018 dhe dt leshimit 28.03.2018 dt skadence 27.03.2019.
- Kontratë Pune datë 15.11.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe K.K në cilësinë e punëmarrësit . Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt leshimi 05.04.2019 Dt skadence 04.04.2020
- Kontratë Pune datë 05.12.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe G.A në cilësinë e punëmarrësit. Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik , Dt e leshimit 04.04.2019, Dt e skadencës 03.04.2020.
- Kontratë Pune datë 01.01.2019 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe M.Z në cilësinë e punëmarrësit . Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik Dt leshimit 04.09.2017 Dt Skadence 03.09.2018,. Dt leshimi 27.03.2018 Dt skadence 26.03.2019.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*.

III.1.4. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon”*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikë nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.5. Referuar parashtrimeve në ankesë vetë ankimesi pranon se *”Dëshmitë e tyre të sigurimit teknik janë të vlefshme, por në dokumentin e kontratës bashkëlidhur ka qenë dëshmia e vjetër dhe jo dëshmia e re e sigurimit teknik. Në fakt është e njëjta dëshmi por vetëm se për cdo vit që bëhet testimi i punonjësve për rregullat e sigurimit teknik në punë bëhet validimi. Bashkëlidhur gjeni dëshminë e sigurimit teknik. Nëse në parimin e AK nuk do të prevalonte qëllimi për të kapur një lapsus por dëshira për të vlerësuar kapacitetet teknike, së pari autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga ofertuesi gjë që ligji i prokurimit publik e kërkon, pasi ky nuk është një dokument që mund të ndryshohet dhe prodhohet nga ne. Ky është një dokument që lëshohet nga një institucion subjekt tjetër i licensuar. Së dyti në mënyrë të pavarur AK mund të bënte verifikime tek sistitucioni subjekti i licensuar që ka lëshuar këtë dokument për vlefshëmrinë e këtij dokumenti.*

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ”Curri” shpk nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacion të plotë për punonjësit me dëshmi kualifikimi të profilit karpentier në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Për tre punonjës të deklaruar si karpentier dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik nuk janë të vlefshme pasi u ka mbaruar afati i vlefshëmërisë së tyre referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në rastin konkret, K.P.P gjykon se ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës *onus probandi incubit actor* (barra e provës i bie kërkuesit). Operatori ekonomik ankimes për faktin e mosdorëzimit të dokumentacionit të vlefshëm në Sistemin e Prokurimeve Elektronike pretendon se ka ndodhur për shkak të një gabimi/lapsusi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu lidhur me dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga ankimesi pranë KPP në respekt të parimit të barazisë dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2 gërma “c” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe në zbatim të nenit 48 pika 4 gërma “b” e LPP, nuk mund të merren në shqyrtim gjatë ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: “Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues “Curri” shpk shpk duhe të kishte paraqitur dokumentacionin të vlefshëm në përputhje dhe kriteret kualifikuese.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Curri” shpk Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3/9 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë :

- Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:
 - 1(një) inxhinier Ndërtimi (profili transport)
 - 1(një) inxhinier Ndërtimi (profili strukture)
 - 1(një) inxhinier Topograf
 - 1(një) inxhinier Hidroteknik
 - 1(një) inxhinier Mjedis (i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)
 - 1(një) inxhinier Gjeolog

III.2.2. Operatori ekonomik ankimues në parashtrimet në ankesë pretendon se *Në përputhje me këtë kërkesë ne kemi paraqitur kontratën me inxhinierin Kol Dedaj me nr.607 rep Nr.107 Kol datë 10.11.2018 lidhur para noterit Ndoc G Topalli.*

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "Curri" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune Nr.607 Rep Nr.107 Kol datë 10.11.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Curri shpk në cilësinë e punëdhënësit dhe K.D në cilësinë e Punëmarrësit me profesion Ing Ndërtimi për Rrugë Ura Vepra Nëntokësore. Diplomë Nr.752-8 lëshuar nga UT në degën ndërtim me titull Inxhinier Ndërtimi për rrugë ura vepra nëntokësore.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*.

III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 "Kontratat për Punë Publike" pika 8 përcaktohet se: *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon"*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.6. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative,

makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik "Curri" shpk nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk kanë paraqitur dokumentacion për një punonjës me profesion inxhinier ndërtimi me profil transport. Dokumentacioni i dorëzuar për inxhinierin e ndërtimit Kol Dedaj për të cilin ankimuesi pretendon se është i profilizuar në transport dëshmon se është diplomuar në inxhinieri ndërtimi me titull Ing Ndërtimi për rrugë ura vepra nëntokësore. Pra në asnjë rast nuk provohet se inxhinieri i ndërtimit K.D është i diplomuar me profil transprt sikundër kërkohet në kriterin e kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.2.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *" [...]/ Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"*.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se “*Kompania e përzgjedhur për tu favorizuar: Referuar ekstraktit historik të kësaj kompanie që ju keni përzgjedhur për të shpallur fituese kjo kompani është krijuar në datën 22.01.2016 me emrin Igor Elektrik shpk. Në datën 07.01.2019 kompania ka ndërruar emrin nga Igor Elektrik shpk në VAS Konstruksion shpk kuptohet kjo për ti paraprirë punës për të marrë këtë tender. Në datën 07 mars 2019 është bërë dhe hapja e kësaj procedure prokurimi që ka pretenduar të marrë kjo kompani. Pra referuar Bilancit Financiar të dy viteve të kësaj kompanie të publikuar në QKB në asnjë ditë të saj kjo kompani nuk është marrë me aktivitet ndërtimi por vtëm me trgëtim dhe instalime të materialeve elektrike. Këtë kompani ju dhe KVO ka zgjedhur të shpallë fitese pa pasu asnjë eksperiencë të vetme në fushën e ndërtimit. Këtë përzgjedhje e keni bërë duke shkaktuar një dëm financiar të paktën 18 mil lekë të reja buxhetit të shtetit. Ky është një investigim i shpejtë mbi kompaninë e përzgjedhur nga ana juaj për ta bërë fituese të një pune që kurrë se ka bërë në tre vite aktivitet që ka, KPP sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” i cili parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real nuk ka sesi të dëmtohet nga suktesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.*

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-12537-03-06-2019, me objekt: “*Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha*”, me fond limit 208,243,180.9 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.04.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 818 Protokolli; Datë 07.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha